



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 59, datë 11.04.2025

**PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUTIT TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT
“SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” SH.A., SI REZULTAT I NDRYSHIMIT TË
STRUKTURËS AKSIONARE**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, të Rregullores nr. 1, datë 25.01.2016 “Për procedurat dhe mënyrën e depozitimit të informacionit dhe dokumentacionit në lidhje me burimin e kapitalit për aksionarët e shoqërisë së sigurimit”, e ndryshuar, si dhe të Rregullores nr. 138, datë 21.12.2015 “Për miratimin ose refuzimin e ndryshimeve thelbësore të statutit të shoqërisë së sigurimit”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e ndryshimit të nenit 6, të statutit të shoqërisë së sigurimit “Sigal Uniqa Group Austria” sh.a., si rezultat i ndryshimit të strukturës aksionare, blerjes së aksioneve të shoqërisë “UNIQA Osterreich Versicherungen AG” nga aksionari i ri, shoqëria “Sigal Business Center” sh.p.k.**
- 2. Miratimin e pjesëmarrjes influencuese në shoqërinë e sigurimit “Sigal Uniqa Group Austria” sh.a., të aksionarit shoqëria “Sigal Business Center” sh.p.k.**
- 3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Saimir TOLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Mimoza KAÇI**